

### “LYRA”-VEPËR E RËNDËSISË SË SHUMËFISHTË

Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti), “Lyra” - Vol. I Botim anastatik i shoqëruar me një studim dhe një CD të regjistrimeve historike të Grupit në vitet 1929 dhe 1930 - Tiranë, 2020, LXXX + 90 f.



Në Mars të vitit 2020 doli nga shtypi vepra me titull “Lyra” e Nestor Mukos (Neço H. Marrioti). Botimi u përgatit nga Qendra Kulturore e Vepërimitarive folklorike tradicionale (QKVT) me drejtues Niko Kotherja. Ky ribotim është anastatik dhe shoqërohet nga një studim dhe një CD e regjistrimeve historike të Grupit të Nestor H. Mukos në vitet 1929 dhe 1930. Kjo vepër me rëndësi të veçantë dokumentare është ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë në të cilën jepen të dhënat biografike të Nestor Mukos (Neço H. Marriotit) dhe të të gjithë anëtarëve të grupit të tij, bashkëpunëtorëve, këngëtarëve e instrumentistëve që shoqëruan këto regjistrime të viteve 1929-1930; dhe në pjesën e dytë është ribotimi anastatik i veprës “Lyra”. Kësaj pjese i paraprin një shkrim nga Saimir Skënduli, MA në Muzikologji, specialist muzike në QKVT, me titull “Kënga polifonike

labe e bregdetit” me theks për këngën polifonike himariote.

Me vetë faktin që është anastatik botimi në fjalë mundëson rikthimin e së njëjtës vepër në bibliotekat tona në gjendjen reale të saj si në vitin 1930, kur ishte botuar për herë të parë, dhe njëherësh përbën pasurim me një vepër shumë pak të njohur. Ky fakt flet për rëndësinë e këtij botimi me shumë peshë e aq më shumë që është realizuar saktësisht pas 90 vjetësh. Më meritori për këtë është padyshim studiuesi korçar Niko

Kotherja që ka bërë një punë të madhe deri të jashtëzakonshme.

Ribotimi i veprës “Lyra” përkon me pjesën e dytë të kësaj vepre. Libri nis me shënimin sqarues: *Vol I- Këngë Moderne-Popullore-Patriotike-Sentimentale-Komike-Satirike-Monologe-Komedira etj., të vjershëruara prej Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti) e të regjistruara të gjitha në PLLAKA ELEKTRIKE PATHÉ.*

Tutje vazhdohet me një sqarim tjetër më të veçantë që vetë autori ia bën kësaj vepre, sqarim që ka të bëjë me nënshkrimin dhe të drejtat e autorit:

“Çdo kopje e këtij libri që s’ka nënshkrimin e autorit, quhet e vjedhur. Regjistrimi i këtyre këngëve në pllaka gramafoni ose çdo përdorim tjetër pa lejen e autorit, ndalohet”. Pason nënshkrimi i Nestor H. Mukos (Neço H. Marrioti-dorëshkrim).

Përmbajtja e këngëve e pjesëve që ka kjo vepër, që janë gjithsej 53, përmban numër rendor, titullin e këngës ose të komedisë, numrin e pllakës dhe numrin e faqes.

Të gjitha 53 pjesët e pikat muzikore, gjegjësisht komiko-deklamativodramatike të shoqëruara nga përcjellja muzikore, kanë numrin dhe titullin e njëjtë si në përmbajtje, ndërkohë që secila këngë, pos titullit, ka në nëntitull një sqarim shtesë, si p.sh.:

28. *Automobili-Pasaxherët*

(Këngë satyrike nga Rivista theatror-“Ortsa-Fortsa” e N. H. M. (Muko) çfaqur a Sarandë-Muzikë aranzh. N.H.M. Pllakë Pathé N. 44010-Kënduar prej ZZ K. Tsakali, M. Rumbo e N. H. Marrioti-Shoqëruar me Piano dhe Violi.ose

36. *Bambumi-(ushtar)-Tetari Kapteri-Marika. (Komedi me këngë-Prosa dhe vjersha N. H. Marrioti (Muko). Pllakë Pathé N. 44017-Çfaqur e kënduar prej ZZ N. H. Marrioti, K. Tsakali, A. Bala e prej Z./shës Tulla Paleologu. Shoqëruar me Piano, Tamburo e dy Violi.*

Nga këto, 26 janë këngë dashurie, 4 janë këngë satirike, 7 janë këngë të lirikës së përgjithshme, 5 janë këngë patriotike, 7 janë pjesë komike të kënduara, 1 është këngë kleftiko për valle çamçe, 1 është këngë lirike fa-

miljare dasme, 1 është këngë kurbeti dhe 1 është lutje kishtare komikosatirike. Që të gjitha këto këngë janë regjistruar nga shtëpia diskografike PATHÉ në disqe Vinyli. Regjistrimi i tyre është bërë në Francë në vitin 1929 (12 disqe) dhe në korrik të vitit 1930 (21 disqe) me të cilat përmbillen këto regjistrime. Duhet thënë se vlerat e këtyre regjistrimeve, përpos për kohën kur janë realizuar, janë të pamatshme bazuar në emrat që i kanë realizuar ato, duke nisur nga: Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti) (1899-1934), Koço Çakalli, Tenor (1901-1963), Llambi Turtulli Tenor (1907-1979), Aristula-Tulla Paleologu, Valltare-Balerinë dhe Soprano amatore, Klea Jorga Kontralto amatore-Artiste e Teatrit “Odeon” në Paris, Mitro Rumbo Bariton amator (1908-1959), e madhja Tefta Tashko Koço (1910-1947), Pano Kokaveshi-këngëtar popullor (1903-1983), Andrea Bala Këngëtar popullor (1902-1937), Maestro Godfrey Andolfi Pianist-Paris. Duhet thënë se Maestro Andolfi udhëhiqte dhe një orkestër dhome me emrin “Vëllezërit Andolfi” ku bënin pjesë një piano, dy violina dhe një klarinetë.

Në fund, pas këngëve, Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti) vendos një “Shënim” ku thuhet:

“Përveç këtyre këngë, janë regjistruar në pllaka Pathé:

HYMNI I FLAMURIT (Kor e orqestrë)- Nr. 44001

MARSHI MBRETNOR Nga një anë Kor e Orqestrë e nga ana tjetër Orqestr’ e madhe - Nr. 44002

*Si dhe populloret e poshtë-shënuara (Autorëve të panjohur)*

ÇERÇIS TOPULLI - Nr. 44031

NËNDEQIND E DHJETË VITI - Nr. 44029

LULE MANUSHAQE- Nr. 44025

DEROPOLITISA - Nr. 44023

KONDISPOLITIA - Nr. 44018

MENUSH AGA - Nr. 44030

NAZE, NAZE, PUNA JOTE(*me mando-lino e kitarë*)- Nr. 44010

LLAJ-ÇOBANI - *Me piano, kërnëtë e violi e në fund me vajtim. Muzika arranzhuar prej N. H. Marriotit (Muko)*- Nr. 44020

MBEÇ MORE SHOKË - *Me muzikë (Piano, kërnëtë e violi) aranzhuar prej N. H. Marriotit (Muko)*- Nr.44010

Të bësh një punë të tillë kaq të madhe krijuese muzikore, aranzhime etj., e të mos kesh një përgatitje shkollore për muzikë, të bësh krijime të tilla poetiko-satiriko-komike e të mos kesh shkollim letrar a gjuhësor, e të vësh në skenë pjesë recitativo-deklamative e satiriko-komike të shoqëruara me muzikë, vetëm një talent shumë i madh si Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti) mbase ka mundur ta bëjë. Kjo flet shumë qartë për erudicionin e madh që ka patur një personalitet si Nestor H. Muko. Mënyra e qasjes në vetë procesin krijues dhe regjistrimin në studio të këtyre veprave, në procesin e të shkruarit të teksteve, reklamimit të tyre, plasimit të duhur të fotografive e deri tek botimi i tyre në një vepër me titullin “Lyra”, është krejtësisht unike në llojin e saj. Puna e tij merr një vlerë të

rrallë ndërkohë që nuk duhet harruar se është viti i largët 1930. Për më tepër, bashkëpunimi dhe aktivizimi i tij me studentët e talentët shqiptarë që bëri në Paris, Sent-Etienne etj. të Francës në vitin 1929, tregon se çfarë shërbimi të madh i bëri kombit dhe vendit. Duke aktivizuar këta talentë, Neço H. Marrioti rriti vlerat shqiptare duke bërë që ato të dallohen e të vlerësohen nga francezët, ndoshta më shumë se nga vetë shqiptarët. Me të drejtë, puna e Neço H. Marriotit duhet të konsiderohet e të trajtohet si e jashtëzakonshme dhe tepër patriotike. Ky vlerësim duhet të ndodhë të paktën në këtë kohë në të cilën po jetojmë, 90 vjet pas bëmave e veprave të tij. Fakti që dhemb më së shumti ka të bëjë me jetën e shkurtër të Neço H. Marriotit. Ai jetoi vetëm 35 vjet. Bazuar në aktivitetin e tij për aq shkurt sa jetoi, vetvetiu del pyetja se, a thua sa vepra e krijime do të arrinte të bënte Neço H. Marrioti po të kishte pasur një jetëgjatësi normale?!

Pjesa e parë që i paraprin “Lyrës” u bë e mundur të botohet falë punës dhe kujdesit të drejtorit të QKVT, Niko Kotherja. Në të bëhet fjalë për Nestor H. Mukon, anëtarët dhe aktivitetin e grupit të tij. Në këtë pjesë, bëhen të ditura biografite e secilit prej tyre dhe të dhëna të shumta për punën, mundimet, kontributin patriotik e sakrificat në ngritjen kulturore të Shqipërisë, pastaj për përndjekjet, vuajtjet, dënimet, persekutimet, internimet, burgosjet deri te vdekjet e bashkëpunëtorëve të Neço H. Marriotit. Më tej bëhet fjalë për jetën kulturore të

Sarandës dhe jo vetëm, në vitet '20 të shek. të kaluar, duke shfrytëzuar shënime të vetë Nestor H Mukos (Neço H. Marrioti), shënime të lëna në Paris në vitin 1924. Në këto shënime, Neço H. Marrioti kishte shënuar biografinë e tij duke filluar nga datëlindja 21 tetor 1899, trangu familjar, shkollimin, si dhe udhëtimet e tij për të punuar dhe për t'u shkolluar në shtete të tjera, duke filluar nga Greqia (1914) ku punoi në oficinën e trenave, por duke ndjekur njëkohësisht disa kurse të natës të shkollës industriale ku u pajis me 'dëshmi' si ndihmësmjeshër-trenist. Sipas këtyre shënimeve, më 1916 kthehet në Himarë ku u punësua sekretar në zyrën e Nën-prefekturës ku qëndroi deri më 1919, vit ky kur u largua sërish për në Greqi. Aty u shkollua dhe më 1923 u diplomua si mekanik-agjustator i mesëm.

Po aty merret vesh se pastaj shkoi në Francë, gjegjësisht në Paris, bashkë me shokët e tij, ku kishte shkruar krijimet e para, e prej andej në Saint Etien ku kishte punuar në minierat e qymyrgurit. Në vitin 1924, Neço Muko kthehet në Sarandë ku rikrijoi grupin "Vetëtima". Duke ecur më tej në këtë mbledhje të mundimshme të dhënash, puna e stërmadhe e studiuesit Niko Kotherja pasqyrohet përmes gjetjes së të dhënave të riformimit të grupit "Pif-Paf", mënyrës së formimit, kushtet në të cilat ai grup ka punuar, vepruar e regjistruar këngë, vështirësitë e ndryshme në sigurimin e fondeve për këto regjistrime apo edhe biografive të të gjithë pjesëtarëve të këtij grupi, gjegjësisht këngëtarëve

dhe instrumentistëve. Kjo e fundit duket të ketë qenë puna më e mundimshme duke ditur se shumica e tyre kishin dekada që jetonin larg Shqipërisë pa pasur mundësi kthimi në atdhe, ndërkohë që tashmë gjeneratat e reja pak dinin për ta. Në mungesë të të dhënave të plota biografike, Kotherja ndërmerri kërkime plotësuese për familjet, shkollimin, aktivitetin dhe karrierën e secilit prej tyre. Qëllimi arrihet me shumë sukses, por me shumë mund. Për këtë gjë, Niko Kotherja shfrytëzoi materiale nga AQSH, Katalogu PATHÉ që sidoqoftë, përmbante pak të dhëna për secilin pjesëmarrës në regjistrimet e këngëve, disa monografi të botuara kushtuar disa prej këtyre personaliteteve, dhjetëra gazeta të botuara në gjuhët respektive në Francë, Itali, ShBA, Shqipëri etj., apo edhe intervista, biseda e konsultime me pasardhës të pjesëtarëve të këtij grupi, ndër të parët e këtij lloji jo vetëm në Shqipëri. Rëndësia e këtij botimi është vërtet e shumëfishtë dhe e jashtëzakonshme për shumë arsye:

1. "Lyra" përfaqëson një botim elitare të kohës, vepër me të cilën tregohet niveli shumë i lartë i përzgjedhjes së këngëve të krijuara nga vetë autori Nestor H. Muko, mënyrës së të aranzhuarit të këtyre këngëve, stileve adekuate të cilave iu takon secila këngë, përcaktimi adekuat i orkestrës për secilën këngë/pikë, kombinimit të këndimit me deklamim, recitim, futja e fragmenteve të polifonisë me iso të jugut të Shqipërisë me theks të veçantë të zonës së Himarës e Sarandës,

përdorimi i figurave të shumta stilistike, si: satira, ironia, simbolika, hiperbola etj.

2. Dashuria e madhe për atdheun, që ishte e pashmangshme për figura të tilla si Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti), dhe dëshira e tij supreme që ta shihte mëmëdheun e tij sa më të përparuar artistikisht e kulturalisht.

3. Me këtë botim anastatik, pasurohet jo vetëm fondi librar me theks të veçantë ai muzikor, por me bashkëbotimin e 12-të këngëve që gjenden në CD, pasurohet edhe fondi zanor shqiptar me regjistrime pak të ditura, pak të njohura e edhe më pak të dëgjura.

4. Kur kësaj i shtojmë dhe bashkëpunimet me G. Andolfi dhe profesionalizmin e treguar nga të gjithë, duke nisur nga e madhja Tefta Tashko, atëherë domosdo se lexuesve dhe sidomos studiuesve të fushës së muzikës, gjegjësisht të Etnomuzikologjisë dhe Muzikologjisë, u ofrohet një perlë e rëndësisë së veçantë kombëtare, vepër e munguar padrejtësisht për nëntë dekada të plota.

Të gjitha sa u thanë më sipër, mund të vërtetohen fare lehtë dhe nga disku që e shoqëron këtë botim, i cili përmban 12 pika muzikore e monologë:

1. Hymni i Flamurit; 2. Kondispolitia;

3. Jo moj jo; 4. Daveli; 5. E dëshpëruara;

6. Nëndëqind e dhjetë viti; 7. Shpresat dhe ëndrat; 8. Saranditia; 9. Mban mend;

10. Vajza e malit; 11. Mitrushi ushtar;

12. Mitrushi.

Këngët që përmban disku, edhe pse mund të thuhet se nuk janë të bollshme si kuantitet, megjithatë, ato në mënyrë bindëse tregojnë nivelin e qasjes së Nestor H. Mukos në shkrimin tekstor poetik e prozaik, mënyrën dhe stilin e të krijuarit muzikor, aranzhimin me formacione të ndryshme orkestrale e realizimin në studion e shtëpisë diskografike Pathé në Paris të Francës.

Si përfundim, duhet të theksohet se puna e Niko Kotheres si drejtor i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (QKVT) është shumë e madhe. Niko Kotherja sjell realitetin artistik të viteve '20 të shek. XX në Sarandë e zonën e Himarës. Përmes kësaj vepre, lexuesi mund të kuptojë fare qartë për shfaqjet muziko-dramatike (Nestor H. Muko nuk i quante koncerte) që pasuronin jetën artistike të kësaj zone dhe më gjerë. Mbase dhe në ato vite, dikush mund ta kishte ditur se autori i këtyre shfaqjeve që ishte Nestor H. Muko, nuk kishte asnjë përgatitje shkollore artistike.

Edhe sot kur bëhet e qartë puna e Nestor H. Mukos, vjen sa e papritur, po aq e çuditshme krijimtaria e një "ndihmësmjeshtri trenist" apo një "punëtori të minierave të qymyrgurit" në Saint Etienne të Francës. Nuk duket se aso kohe, në vitet '20-'30 të shek. XX të kenë ardhur po aq të papritura pasi Nestor H. Muko ishte frymëzuesi i grupit të djalërisë bregdetare "Ve-

tëtima”, pasi Neçoja pati rikrijuar grupin “Vetëtima” nën emrin e ri si mbulesë “Grupi koral” që më tutje do të paraqitej e prezantohej si shoqëria “Miqtë e dëfrimit” me emrin “Pif-Paf” grup me të cilin Neço H. Muko organizoi shfaqjet e para artistike të Sarandës së asaj kohe me pak më shumë se 4.300 banorë; pasi Neçoja kishte organizuar shfaqjet e tij në disa revista teatrale të emërtuara “Marrëzi e përgjithshme”, “Ortsa-Fortsa”, “Tirana qesh” etj., që u shfaqën në Sarandë dhe pasi Neçoja mendohet të ketë dhe krijime të tjera, si: këngë, komedi e pjesë satirike të cilat tashmë janë të humbura. Edhe nëse dëgjuesit e asaj kohe dinin për to, ne kemi kuptuar për to vetëm pas 90 vjetësh. Dhe janë pikërisht këto fakte për të cilat sot duhet të ndihemi fajtorë lidhur me shpërdorimet shumë të mëdha që u janë bërë këtyre krijimeve. Për ekzistimin e veprave të tjera të Neço H. Mukos njoftohemi dhe nga artikujt e botuar në revistën e kohës me emër të njëjtë si të grupit “Pif-Paf” ku u botuan dy poema satirike: “I kënaquri” dhe “Kozmogonia” ose edhe për humbjen e përkthimit të libretit të Gennaro Federicos të shkruar për operën “Shërbëtorja zonjë” e kompozitorit italian Giovanni Battista Pergolesi (1710-1736).

Me vetë faktin se Nestor H. Muko i kishte vënë veprës së tij “Lyra” shënimin “Vol.I”, tregon se autori planifikonte të bënte edhe Vol. II të së njëjtës vepër, ku do të përfshiheshin krijime të tjera të tij. Krijime të tjera të tij humbën ndërkohë që botimi i Vol.

II u bë i pamundur pasi Nestor H. Muko vdiq fare i ri, në vitin 1934 kur ishte në moshën 35-vjeçare, duke lënë mjaft dorëshkrime, të papërfunduara. U varros në Himarë. Për më keq, varri i tij u dëmtua nga dashakëqijtë dhe humbi fare për t’u gjetur pas shumë dekadash në shek. XXI nga zotërinjtë Irakli Kokaveshi dhe Lefter Çipa, ndërkohë që krijimtaria e tij u la në harresë të plotë gjatë diktaturës komuniste. Që të gjitha këto fakte na i servon Niko Kotherja në shtesën/pjesën e parë të veprës “Lyra”. Ndaj, nga sa u tha, qëndron edhe merita e madhe e studiuesit dhe historianit Niko Kotherja për punën e madhe që ka bërë në ndriçimin e figurës dhe veprës së artistit të madh shqiptar Nestor H. Muko (Neço H. Marrioti). Ky botim dhe këto fakte na bëjnë krenarë për arritjet artistike të kohës por, na bëjnë dhe fajtorë për harresën, anashkalimin, shpërdorimin deri në asgjësimin e veprave të nivelit të lartë artistik të krijuara nga Nestor H. Muko. Përfundimisht, nga sa ka ndodhur me këto vepra, humbës kemi qenë vetë ne, ndërkohë që përfituesi më i madh duket se do të jetë vetë Nestor H. Muko, vepra e të cilit e ripa dritën e botimit pas nëntë dekadash. Bashkë me të, përfitues tani e tutje do të jenë të gjithë studiuesit e Muzikologjisë dhe Etnomuzikologjisë, pasi ka mundësi që të njëjtat vepra të transkriptohen e të botohen në të ardhmen për t’u shërbyer më pas të gjithë studiuesve të këtyre dy fushave shkencore.

**Behar ARLLATI**